



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:084578
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05584896

Ac.nr.1852/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses Elektromotori sh.a., (sh Gorenje Elektromotori), me seli në Gjakovë, rr. “Skënderbeu” pn., të cilën e përfaqëson I.Zh, drejtor tek paditësja, kundër të paditurit Sh.K. nga Gjakova, rr. “...” Blloku ... Hyrja ..., Kati ..., nr....., për shkak të lirimit të banesës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.318/2018, datë 27.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurit Sh.K. nga Gjakova, rr. “...” Blloku ... Hyrja ..., Kati ..., nr....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.318/2018, i datës 27.01.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.318/2018, të datës 27.01.2020, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Elektromotori sh.a. (ish Gorenje Elektromotori), me seli në Gjakovë, rr. “Skënderbeu” pa nr., në tërësi si e bazuar.

- II. DETYROHET i padituri Sh.K. nga Gjakova, që t'ia liroj dhe t'ia dorëzoj në posedim paditëses Elektromotori sh.a., (ish Gorenje Elektromotori), me seli në Gjakovë, banesën për disponim të lirë dhe të qetë, e cila evidentohet si ngastër kadastrale nr...., pjesë e ndërtesës në sipërfaqe prej m2, ZK, Gjakovë Qytet, e cila gjendet në Rr. “.....”, Blloku ..., Hyrja ..., Kati ... nr..., në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën në tërësi si të bazuar dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, kundër të paditurit me datë 25.05.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për lirimin e banesës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit për lirimin e banesës lëndore që gjendet në adresën “.....” Blloku ..., Hyrja .., Kati ..., nr..., nga njerëzit dhe gjësendet, obligohet i padituri që paditëses t'ia dorëzoj banesën në disponim të lirë dhe këtë në afatin prej 30 ditësh nën kërcënim të përmbarimit me dhunë dhe të obligohet i padituri që të bëjë kompensimin e të gjitha shpenzimeve lidhur me këtë kontest gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.318/2018 të datës 27.01.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadijinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka parashtuar se nga provat shkresore, respektivisht aktgjykimi C.nr.865/09 i dt.16.05.2016, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, vërtetohet fakti se sipas padisë së paditëses të paraqitur në vitin 2016, është aprovuar kërkesëpadija dhe është shkëputur kontrata për shitblerjen e banesës nr. 02-3865/2, e datës 14.11.1991 dhe e legalizuar me nr. Leg. Nr....., datë 31.12.1991, e lidhur në mes të Gorenje Elektromotori sh.a., me seli në Gjakovë dhe të paditurit Sh.K. nga Gjakova. Sipas aktgjykimit në fjalë, paditësja siç rezulton nga certifikata pronësore, është regjistruar si pronare e banesës lëndore. Duke qenë se kontrata për shitblerjen e banesës lëndore është anuluar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa i padituri të njëjtën banesë vazhdon ta mbajë pa bazë ligjore, prandaj nga arsyet e theksuara gjykata e çështjes ka ardhur në përfundim se në rastin konkret kërkesëpadija për lirimin e banesës është e bazuar dhe të njëjtën e aprovoi në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejta Tjera Sendore, lidhur me nenin 143 të LPK-së, duke e detyruar të paditurin që banesën ta liroj nga njerëzit dhe sendet dhe të tillë t'ia dorëzoj paditëses në posedim, në afatin prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, i ekzekutueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Gjykata në pjesën e arsyetimit ka parashtruar se si provë vendimtare për aprovimin e kërkesëpadisë në rastin konkret e vlerësoi aktgjykimin e formës së prerë C.nr.865/09, dt.16.05.2016, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, me të cilin aktgjykim është anuluar kontrata e vitit 1991 për shitblerjen e banesës, e cila ishte lidhur mes këtu palëve ndërgjyqëse. Fakti se kontrata ishte anuluar, ndërsa banesa lëndore është regjistruar në pronësi të paditëses, është konsideruar si bazë juridike që paditësja si pronare e banesës lëndore të kërkoj gëzimin e plotë të të drejtës në pronë, përkatësisht të kërkoj lirimin e paluajtshmërisë të cilën i padituri e mban pa bazë juridike. Në mënyrën e parashtrimit të arsyeve për faktet vendimtare dhe referuar përmbajtjes së aktgjykimit, gjykata ankimore vlerëson se aktgjykimi i atakuar përmban të gjitha kërkesat ligjore nga dispozitat e nenit 160 të LPK dhe i njëjti nuk përshihet me shkelje të dispozitave procedurale të pretenduara si në ankesën e palës së paditur.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë, sepse gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale nr.me kulturë banesë,, me sipërfaqe prej, në bazë të certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme evidentohet në emër të paditëses këtu Gorenje Elektromotori sh.a., me seli në Gjakovë dhe se njëjta në këtë rast është pronare juridike. Po ashtu në këtë rast Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin C.nr. 865/09 të datës 16.05.2016 e ka shkëputur kontratën mbi shitblerjen e banesës me nr. 02-3865/2 të datës 14.11.1991, pasi që i padituri ka dështuar t'i përmbahet kësaj kontrate. Në kuptim të kësaj gjendje faktike rezulton se aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale nga neni 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), ku përcaktohet se: "Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtoj nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti ". Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në këtë rast paditësja mund të disponojë lirshëm me pronën e saj, ngase në bazë të gjendjes faktike nuk është vërtetuar se me disponimin e lirshëm do të mund të binte në kundërshtim me ligjin apo me të drejtat eventuale të dikujt tjetër. Pra, paditësja gëzon të drejtën e tërësishme ndaj banesës së lartcekur, të cilën mund ta disponojë sipas dëshirës dhe vullnetit të saj përderisa ka arritur t'i vërtetoj faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e vetë në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, gjegjësisht ka arritur të argumentoj se është pronare e paluajtshmërisë lëndore - banesës dhe se i takon e drejta e shfrytëzimit të banesës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike - kontestimore, në përputhje me tarifën për caktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2019:084578
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05584896

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika d) e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1852/20, me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli